

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Kolegji për të mitur i përbërë nga gjyqtarët Rasim Rasimi, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bujar Ahmeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.G., nga fshati ..., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale marrëdhënie seksuale me dhunë nga neni 74 par 1 të LPK, të aplikuar sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.24/99, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit R.G., av. F.G.-B., si dhe ankesës së përfaqësueses së autorizuar të dëmtuarës E.Sh., av. D.H., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për të Mitur, PM.nr.285/2013, të dt.15.05.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.11.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara, ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit R.G., av. F.G.-B., si dhe ankesa e përfaqësueses së autorizuar të dëmtuarës E.Sh., av. D.H., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për të Mitur, PM.nr.285/2013, të dt.15.05.2017, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për të Mitur, PM.nr.285/2013, të dt.15.05.2017, është shpallur fajtor i akuzuari R.G., për shkak të veprës penale marrëdhënie seksuale me dhunë nga neni 74 par 1 të LPK, dhe i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.31.08.1999, e deri me dt.29.09.1999.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor shumë prej 200 (dyqind) €, si dhe në emër të taksës për kompensim të viktimave të krimit shumë prej 50 (pesëdhjetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara E.Sh., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë:

- Prokuroria Themelore në Prishtinë, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i lartë,

- mbrojtësja e të akuzuarit R.G., av. F.G.-B., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit mbi dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe i akuzuari të lirohet nga akuza, ose të njëjtin ta prishë, dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje, si dhe

- përfaqësuesja e autorizuar e të dëmtuarës E.Sh., av. D.H., për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i lartë.

Prokuroria e Apelit, me parashtresën PPAM/I.nr.87/2017, të datës 04.10.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e ushtruara, ka propozuar që të aprovohen si të bazuara, ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, dhe ankesa e përfaqësueses së autorizuar të dëmtuarës E.Sh., av. D.H., kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i lartë me burgim efektiv, kurse sa i përket ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit R.G., av. F.G.-B., të refuzohet si e pa bazuar.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, Gjykata e Apelit, ka caktuar seancën e kolegjit, për të cilën i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës. Nga shkresat e lëndës rezulton se në seancën e kolegjit ka prezantuar i akuzuari R.G., mbrojtësja e të akuzuarit, av. F.G.-B., e dëmtuara E.Sh., si dhe përfaqësuesja e autorizuar e të dëmtuarës, av. D.H., kurse palët tjera nuk kanë prezantuar, përkundër asaj që njoftimet i kanë pranuar në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesat e ushtruara, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesat, e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, mbrojtëses së të akuzuarit R.G., av. F.G.-B., si dhe ankesa e përfaqësueses së autorizuar të dëmtuarës E.Sh., av. D.H., nuk janë të bazuara.

Sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat konsistojnë në kuptim të nenit 384 par 1 pika 1.8 të KPPK, sepse aktgjykimi i ankimuar është mbështetur në prova të pa pranueshme, dhe i njëjti nuk është përpiluar në kuptim të dispozitës ligjore nga neni 370 të KPPK. Sa i përket dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, i njëjti nuk është në harmoni me vetveten, për çka bëhet i pa kuptueshëm, e gjithashtu nuk janë dhënë arsyet përkitazi me provat vendimtare të cilat e karakterizojnë çështjen penale. Gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur saktësinë e provave, nuk janë konstatuar faktet nga kjo çështje penale, sepse po të ishin bashkërenditur të njëjtat, atëherë me siguri që vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk do të ishte sikurse është nxjerrë. Nga aktgjykimi i ankimuar, rezulton se provat vetëm se janë përshkruar, përkitazi me çështjen penale, ashtu që të njëjtat janë konfuze, të pa qarta dhe kontradiktore, dhe nuk e kanë bazueshmërinë e duhur juridike. Si rezultat i shkeljeve për të cilat pretendohet, përkundër asaj që i akuzuari R.G., është akuzuar për shkak të veprës penale marrëdhënia seksuale me dhunë nga neni 74 par 1 të LPK, përkatësisht koha e kryerjes së veprës penale nuk përputhet me kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet i njëjti, nga propozimi i prokurorit të shtetit, dhe ajo rezulton si në vijim, në faqen tre, pasuesi katër, rreshti i dytë, në të cilin prokurori ka precizuar datën e kryerjes së veprës penale, dhe atë nga data 30.08.1999, kurse në aktakuzë përshkruhen veprimet e kryera me datën 16.08.1999, ndërsa në pjesët tjera

aktakuza ka mbetur e pa ndryshuar, që paraqet pyetje në veti se si është e mundur që të kalojnë 18 vite, nga kryerja e veprës penale, e atëherë të bëhet ky ndryshim. Veprimet të cilat janë ndërmarrë në kohën e kryerjes së veprës penale, sikurse theksohet në aktvendimin për fillimin e hetimeve, kanë qenë të kryera me datën 31.08.1999, andaj, lind pyetja se a kemi të bëjmë me ndonjë gabim teknik apo realitet. Përkundër asaj që ky fakt është shumë me rëndësi, sepse është me rëndësi që të dihet koha e kryerjes së veprës penale, të cilët vërehen 18 vite pas kryerjes së të njëjtës. Sa i përket çështjeve të tjera, elementeve inkriminuese të cilat e karakterizojnë çështjen penale, jemi të mendimit se asnjë provë nuk është proceduar në atë masë me të cilën do të vërtetohej se i akuzuari ka kryer veprën penale në dëm të dëmtuarës, e dëgjuar në cilësinë e dëshmitares, dhe në këtë mënyrë jemi të mendimit se gjykata e shkallës së parë nuk është dashur që tua falë besimin. Si mungesë e vërtetimit të elementeve inkriminuese të veprës penale, rezulton se aktgjykimi i ankimuar nuk është i pranueshëm, dhe si i tillë kjo çështje penale duhet të anulohet.

Kolegji për të mitur i kësaj gjykate, e ka shqyrtuar dhe vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, sipas ankesës së ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, në kuptim të nenit 394 të KPPK, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, dhe ka ardhur në përfundim, se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten, dhe me arsyetimin e të njëjtit, ngase përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare të cilat e karakterizojnë veprën penale marrëdhënia seksuale me dhunë nga neni 74 par 1 të LPK, të aplikueshme sipas Rregullores së UNMIK-ut, nr.24/99, e gjithashtu nga shkresat e lëndës rezulton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është marrë duke u bazuar në prova të pranueshme, të cilat janë paraqitur në arsyetim të aktgjykimit, pasi që kanë kaluar procedurën sipas dispozitave ligjore në fuqi. Gjykata me aplikimin e drejtë të dispozitave ligjore, në mënyrë të pa dyshimtë ka vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, që nënkupton se në mënyrë të saktë dhe të qartë ka vërtetuar elementet inkriminuese të veprës penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit. Sa i përket provave për të cilat thirret mbrojtësja e të akuzuarit, se të njëjtat nuk janë marrë në kuptim të dispozitës përkatëse ligjore nga neni 384 par 1 pika 1.8 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate është i mendimit se që të gjitha janë marrë duke kaluar procedurën sikurse kërkojnë dispozitat ligjore, ashtu që të njëjtat janë të pranueshme. Sa i përket kohës së kryerjes së veprës penale, dispozitat ligjore ia lënë atë mundësi prokurorit të shtetit që në fjalën përfundimtare ta bënë precizimin e kohës së kryerjes së veprës penale, kur të bënë përshkrimin faktik të veprës penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit, andaj, në këtë drejtim nuk mund të flitet për ndonjë lëshim nga ana e prokurorisë, sepse prezenca e palëve në procedurë ka ofruar mundësi që çështja penale të trajtohet në kuptim të dispozitave ligjore. Gjithashtu aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është punuar në kuptim të dispozitës ligjore nga neni 370 të KPPK, sepse përmban formën e kërkuar me shkrim, si dhe karakteristikat të cilat duhet ti ketë një aktgjykim, sikurse parasheh dispozita përkatëse ligjore, dhe se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë ka dhënë arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, duke arsyetuar se cilat fakte dhe për çfarë arsye konsiderohen të vërtetuara, si dhe ka paraqitur saktësinë e secilës provë e cila karakterizon çështjen penale dhe është me rëndësi për ekzistimin e veprës penale si dhe vërtetimin e përgjegjësisë penale të akuzuarit, andaj, aktgjykimi gjykatës së shkallës së parë si i tillë është i pranueshëm për kolegjin e kësaj gjykate.

Sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të shkeljes së ligjit penal, të cilat shkelje konsistojnë në kuptim të nenit 385 par 1 pika 1.2 të KPPK, sepse nuk janë ofruar prova të mjaftueshme të cilat e vërtetojnë se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, andaj, si rezultat i kësaj, gjykata e shkallës së parë është dashur që të akuzuarin ta përjashtojë nga përgjegjësia penale. Kjo vie në shprehje para së gjithash, sepse me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, çka nënkupton që gjykata e shkallës së parë nuk e ka realizuar detyrimin ligjor për arsyetimin e vendimit përkitazi me veprën penale e cila i vihet në barrë.

Kolegji për të mitur i kësaj gjykate e ka shqyrtuar dhe vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, në kuptim të neni 385 të KPPK, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal, se vepra penale për të cilën është akuzuar i akuzuari parashihet me ligjin e aplikueshëm, se nuk ekzistojnë rrethana që përjashtojnë të akuzuarin nga përgjegjësia penale dhe ndjekja penale, se gjykata në mënyrë të drejtë ka zbatuar ligjin i cili ka qenë aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, se gjykata ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, andaj, aktgjykimi i ankimuar është i pranueshëm për kolegjin e kësaj gjykate.

Sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e ankimuar e ka mbështetur në fakte të pa vërtetuara në seancën kryesore. Sa i përket të akuzuarit R.G., i njëjti gjatë të gjitha fazave të procedurës, para të gjitha organeve në mënyrë të qartë ka theksuar se nuk e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, por ditën kritike ka qenë në shoqëri me të miturën dhe me një shok. Sa i përket të miturës, nuk e ka njohur, dhe se të njëjtën edhe më pas asnjëherë tjetër nuk e ka takuar. Sa i përket akuzës e cila është ngritur kundër të akuzuarit, rezulton se vepra penale është kryer me dt.30.08.1999, parashtrohet pyetja a duhet ti besohet një deklaratë të tillë, të dëmtuarës, sepse për veprën penale të kryer në dëm të saj, e njëjta asnjëherë nuk ka qenë në ndonjë qendër medicinale për të kërkuar ndihmë, andaj, sa i përket gjendjes faktike, e njëjta nuk është vërtetuar me asnjë provë, sepse të gjitha pyetjet të cilat iu janë parashtruar të dëmtuarës, me përgjigje të dhëna nuk është mundur që të vërtetohet gjendja faktike, dhe të bëhet përkrahimi i rastit të ndodhur. Pasi që deklaratat kanë qenë kontradiktore, atëherë gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar nenin 3 par 1 dhe par 2 të KPPK, të parimit “se çdo dyshim është në favor të pandehurit”, në këtë mënyrë të akuzuarin e ka shpallur fajtor pa e provuar fajësinë e tij për veprën penale e cila i vihet në barrë. Gjithashtu, gjykata e shkallës së dytë duhet të vlerëson aktgjykimin, e sidomos në faqen nëntë, pasuesi i dytë, rreshti njëzetë, ku theksohet se të njëjtën i akuzuari me shokun e tij e kanë kthyer në qytet dhe e kanë hedhë prej veturës para hotelit Ballkan, të përgjakur prej goditjeve në fytyrë, e cila edhe është alivanosur, por parashtrohet pyetja se një deklaratë e këtillë e dhënë në kohën e kryerjes së veprës penale, a ka qenë e saktë, sepse e njëjta e ka dhënë në shtabin UÇK, në Prizren, ku ka shkuar për të kërkuar ndihmë, por pasi të njëjtën nuk e gjen, ka shkuar që ndihmën ta kërkojnë te ushtarët e KFOR-it Gjerman. Gjukata vazhdimisht ka vlerësuar deklaratën e të dëmtuarës, e cila ka përkrahur rastin e ndodhur, ditën kritike, duke theksuar se pasi që janë takuar në një restorant afër fshatit Llapnasellë, i akuzuari e ka detyruar që të ketë marrëdhënie seksuale, duke e dërguar në dhomë të restorantit, duke ia zhveshur rrobat nga trupi, dhe pasi që ia ka vendosur një qarshafë-pjesë të qarshafit, ka kryer akt seksual me dhunë, e shpesh edhe e ka goditur.

Kolegji për të mitur i kësaj gjykate, ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se ditën kritike i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, e cila rezulton nga deklaratat e të dëmtuarës, e cila e ka përkrahur në mënyrë detale se si ka ardhur deri te kryerja e aktit seksual, përkatësisht marrëdhënies seksuale me dhunë nga ana e të akuzuarit, e cila deklaratë materializohet edhe me deklaratën e dëshmitares N.Sh., e cila ka përkrahur rastin e ndodhur ditën kritike, duke theksuar se e dëmtuara është dhunuar nga ana e të akuzuarit, pasi që e ka vërejtur gjendjen e saj pas kryerjes së veprës penale. Gjithashtu edhe nga deklaratat e dëshmitarëve V.D., S.G., N.Sh., E.A.,Sh.B.,dhe B.G., në mënyrë indirekte vërtetohet se nga ana e të akuzuarit është kryer vepra penale në dëm të dëmtuarës, duke u materializuar edhe me provat materiale nga shkresat e lëndës, andaj, kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, provat nga shkresat e lëndës, sikurse ato personale, po ashtu edhe ato materiale, dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës

së parë drejtë ka vendosur kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale, dhe i ka shqiptuar dënimin përkatës ligjor.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë të akuzuarit nuk i ka shqiptuar dënim adekuat përgjegjësisë penalo-juridike të akuzuarit për veprën penale, se nuk e ka vlerësuar në masë të duhur dispozitën ligjore nga neni 73 të KPK, për të vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, por ka patur parasysh vetëm rrethanat lehtësuese, se i akuzuari asnjëherë tjetër nuk ka rënë në kundërshtim me ligjin, se ka patur sjellje korrekte në gjykatë, se prej kohës së kryerjes së veprës penale nuk ka rënë në kundërshtim me ligjin, e gjithashtu ka paraqitur një pjesë të rrethanave rënduese, e sidomos ka patur parasysh gjendjen shëndetësore dhe emocionale të dëmtuarës pas kryerjes së veprës penale, dhe të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, mirëpo jemi të bindur se me një dënim të këtij lloji nuk do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit i paraparë me ligj.

Ankesë, ka ushtruar edhe përfaqësuesja e autorizuar e të dëmtuarës, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë të akuzuarit i ka shqiptuar dënim mjaftë të ulët-të butë, për veprën penale marrëdhënia seksuale me dhunë nga neni 74 të LPK, për çka jemi të mendimit se një dënim i këtij lloji është nënçmues dhe ofendues për të dëmtuarën, që nuk përkon me peshën e veprës penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit, e sidomos është dashur që të kihet parasysh që vepra penale është kryer në dëm të një fëmije të moshës 14 vjeçare, të pa mbrojtur, nga një burrë 36 vjeçar, andaj, duke patur parasysh të gjitha këto elemente përkatësisht rrethana, gjykata e shkallës së parë është dashur që të vlerëson se i akuzuari veprën penale e ka kryer përmes përdorimit të forcës fizike, se viktima ka qenë e pa mbrojtur, se i është shkaktuar dëm i konsiderueshëm, andaj, duke i vlerësuar të gjitha këto rrethana, jemi të mendimit se dënimi nuk është proporcional me shkallën e intensitetit të kryerjes së veprës penale, dhe propozojmë dënim më të ashpër.

Gjithashtu, ankesë për shkak të vendimit për dënimin, ka ushtruar mbrojtësja e të akuzuarit, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar në masë të duhur rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, e sidomos është dashur që të ketë parasysh, se i akuzuari është njeri familjarë, se më parë nuk ka qenë i dënuar, se ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale, e sidomos kohën e kaluar prej kryerjes së veprës penale, gjerë në vendosje, kohë 18 vjeçare, andaj, jemi të mendimit se me dënimin e shqiptuar nuk mund të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit, sepse edhe ashtu i akuzuari ka jetuar nën ankthin e ndëshkimit që mund ti vijë nga vepra penale. Duke i patur parasysh të gjitha këto rrethana, e sidomos duke patur parasysh se aktgjykimi i ankimuar përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, me shkeljet e ligjit penal, si dhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, atëherë propozojmë që kolegji i Gjykatës së Apelit, që të akuzuarin ta lirojë nga akuza, ose çështjen penale ta anulon, dhe çështjen penale ta kthen në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, e ka shqyrtuar dhe vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesat e ushtruara, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, nuk janë bërë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet të ligjit penal, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, andaj, duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, kolegji vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari pas kryerjes së veprës penale nuk ka rënë në kundërshtim me ligjin, se është familjarë, ka

vlerësuar kohën e kryerjes së veprës penale gjerë në vendosje, ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese, e sidomos ka patur parasysh se vepra penale është kryer në dëm të dëmtuarës së mitur, andaj, në prani të këtyre rrethanave, e duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese apo rënduese, kolegji i kësaj gjykate, është i bindur se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.462/2017, dt. 22.11.2017

**Zyrtari Ligjor
Bujar Ahmeti**

**Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit
Rasim Rasimi**

Biljana Rexhiq